



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 18**

**Datë: 21. 06. 2022. Ora: 13: 00**

**Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.**

**Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.**

**Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.**

**SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.**

**ZRPPC: Nexhmedin Hyseni, drejtor i ZRPP**

**Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.**

---

**RENDI I DITËS**

**1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

**2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes Nr.15 dhe 16-2022**

**3. Aktivitetet e SKQZ-së:**

**4. Aktivitetet e ZRPPC-së:**

- Raporti i Aktiviteteve të ZRPPC-së,

- Rekomandim për pezullimin e partisë politike Pokret za Župu i Dijasporu me akronim ŽUPSKA, dhe

- Rekomandim për shtyrje të afatit të fundit për mbajtjen e Kuvendit Zgjedhor për Partinë e Ashkalinjëve për Integrim me akronimin PAI.

**5. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë së Listës Votuese
- Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit “Analizë e adresave – Krahasimet me bazën e të dhënave të Departamentit të Prodhimit të Dokumenteve dhe Departamentit të Gjendjes Civile,
- Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit “Hulumtimi dhe analizimi i fletëvotimeve të pavlefshme për Zgjedhjet Lokale 2021”,
- Njoftim për Planin e Vizitave me Kryetar të Komunave të Republikës së Kosovës

- **Këshilli për Çështje Ligjore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Kamenicë dhe Mitrovicën e Veriut.

- **Këshilli për Buxhet dhe Financa:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i draft-Plani i Buxhetit Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 2023-2025,
- Shqyrtimi dhe miratimi i Raporti Vjetor Financiar i Fondit për Mbështetje të Subjekteve Politike për vitin 2021.

**6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për anëtar të jashtëm të Komitetit të Auditimit të Brendshëm të KQZ-së.**

**7. Të ndryshme. HULUMTIMI DHE ANALIZIMI I FLETËVOTIMEHULUMTIMI DHE ANALIZIMI ZGJEDHJET LOKALE 2021**

---

- **Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

**Kreshnik Radoniqi**, kryetari i KQZ-së paraqiti rendin e ditë, dhe pyeti nëse dikush ka diçka për të shtruar...! Arianit Elshani, kërkoi heqjen nga rendi i ditës të pikës “Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit “Analizë e adresave – Krahasimet me bazën e të dhënave të Departamentit të Prodhimit të Dokumenteve dhe Departamentit të Gjendjes Civile” dhe pika tjetër e radhës nga KOZ: “Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit “Hulumtimi dhe analizimi i fletëvotimeve të pavlefshme për Zgjedhjet Lokale

2021". Kjo për faktin se, këto dy pika nuk është arritur të shqyrtohen në KOZ, duke i dhënë prioritet shqyrtimit të rregullës zgjedhore "Këshillat e Vendvotimit", dhe shqyrtimin dhe votimin e planit të vizitave...

**Alim Rama,** tha se i vetmi këshill, është këshilli ligjor që për shkak të natyrës së tij dhe afatit të çështjeve ligjore, çështjet duhet patjetër të shqyrtohen dhe të miratohen, mirëpo jo çdo pikë në këshillat e tjerë, mbasi që shqyrtohen duhet edhe të aprovohet...

**Me largimin e dy pikave nga KOZ, me 9 vota për miratohet rendi i ditës. Në vazhdim, miratohen procesverbalet 15, dhe 16 të mbledhjeve të KQZ-së.**

## **2. Aktivitetet e SKQZ-së:**

Pika tjetër e rendit të ditës, janë aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së të cilat, u referuan në mes të mbledhjeve nga kryeshefi, **Burim Ahmetaj.** Ai, tha se gjatë muajit qershor është pranuar raporti nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2021, dhe janë tri rekomandime. Dy nga to, lidhen me tjetërsimin dhe zhvleftësimin e pasurive jo financiare. Kryeshefi, tha se shpërndarja e tabletëve si pasuri e tjetërsueshme organizatave që kanë shprehur interesim, është në proces e sipër. Përmes ankandit publik dhe procedurave të prokurimit, po ashtu, do të procedohet me pasuri të tjera jo financiare të KQZ-së, kurse problem mbetet asgjësimi i Spreit Ultraviolet...

Po ashtu, edhe shkatërrimi i materialit të ndjeshëm zgjedhor nga zgjedhjet e 17 tetorit 2021, është një çështje në procedim e sipër dhe Sekretariati po punon në këtë drejtim. Sekretariati, po punon edhe për hartimin e "Listës së rreziqeve" që do na shërbej edhe në të ardhmen. Ahmetaj, tha se çështja e Softverit për Sistemin e Integruar të Rezultateve, apo procedura e aplikimit është përmbyllur dhe se OSBE si financuese, është në fazën e vlerësimit...Kështu, pas kësaj, Sekretariati do të kyqet në zhvillimin e softverit, ashtu si edhe KQZ sepse kjo është shumë me rëndësi për ne...

Në vazhdim, z. Ahmetaj e informoi KQZ-në për emërimin e ushtrueseve të detyrave përmes një raporti, ndërsa që tri pozita për shkak të ankimeve në gjykata, nuk janë emëruar ushtruesit e detyrës...

Z. Ahmetaj, informoi edhe rreth sigurimit të parkingjeve për automjetet e KQZ-së, rreth punës në hartimin e rregullave të KQZ-së, dhe çështje të tjera...

**Sami Kurteshi**, pyeti rreth plotësimit të vendit të anëtarit të Komitetit të Audimit, dhe pastaj, edhe rreth shkatërrimit të materialit zgjedhor – letrës, pastaj edhe rreth spreit – shkatërrimit të këtij materiali... Ai, propozoi që të mos kontraktohet më kësi materiali, të gjendet një zgjidhje tjetër...! Unë mendoj që KOZ-i të diskutoj, ashtu si edhe ne që të gjendet një zgjidhje tjetër...

Po ashtu, Kurteshi kërkoi që anëtarëve të KQZ-së, tu dërgohet raporti i ZKA-së.

**Arianit Elshani**, tha se janë 9 vite që spreit ultravioletë është grumbulluar, dhe mendoj se me Ministrinë e Ambientit, duhet patjetër të vihen kontakte dhe të gjendet zgjidhja e shkatërrimit të tyre...

Letra, domethënë fletvotimet dhe materiali tjetër zgjedhor, të shkatërrohet në një formë që të shitet ky material...Kemi pasur një procedurë të prokurimit për shkatërrim të materialit, por jo edhe marrjes ose shitjes së materialit..Në Kosovë, nuk ka kompani që riciklon letrën...Pra, ne duhet ta gjejmë një mënyrë...

Lidhur me raportin e Sekretariatit, Alim Rama tha se shpërndarja – donacioni i tabletëve të bëhet në bazë të rregullt, e të mos kemi pastaj probleme rreth procedurave, njësoj si edhe me çështjen e letrës...Ndërsa, rreth emërimit të ushtruesve të detyrës në Sekretariat, z. Rama theksoi që kjo çështje duhet të përcaktohet përmes një rregulloreje të caktuar, pra të përkufizohen kushtet e emërimit, dhe jo në forma të ricikluara...

**Burim Ahmetaj**, tha se sa i përket pyetjes rreth anëtarit të ri të Komitetit të Audimit, emri i tij është dërguar te Auditori i Brendshëm dhe ai, është dashur ta informoj komitetin dhe më gjerë. Pra, Universiteti i Prishtinës na ka përkrahur me një zyrtar i cili, do të jetë pjesë e KO-së si anëtar i jashtëm...

Z. Ahmetaj, shpjegoi edhe çështjen e shkatërrimit të materialit zgjedhor, dhe se duhet ndoshta që kontraktorit, t'i dhurohet edhe letra, domethënë shkatërrimi dhe dhurimi...

Kurse, çështja e procedurës së “ushtruesve të detyrës”, do të jetë e fokusuar në rregulloret e ardhshme të KQZ-së...

**Kreshnik Radoniqi**, tha se ishte dashur të hartohet një rregullore komplet e re, se kështu janë të rregulluara edhe institucionet, pra, rregullimi i brendshëm: mënyrën e rregullimit, procedurën ankimore, të gjitha... Pra, duhet ta kemi rregulloren tonë të organizimit të brendshëm...

Në këtë pikë, diskutuan edhe: Arianit Elshani, Alim Rama, Nexhmedin Hyseni, Kreshnik Radoniqi, Ilir Gashi, Čemailj Kurtiši dhe Sami Kurteshi.

### **3. Aktivitetet e ZRPPC-së**

#### Raporti i Aktiviteteve të ZRPPC-së

Nexhmedin Hyseni, drejtor i ZRPPC, tha se zyra, më 5 qershor 2022, Zyra pasi ka pranuar ftesën për monitorimin Kuvendit të nëntë (IX) zgjedhor të Partisë Politike Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), i cili kuvend është mbajtur me datë 5 qershor 2022, në Prishtinë. Zyra përmes Zyrtares së Lartë për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim, Valmira Selmani, ka bërë monitorimin e kuvendit zgjedhor të partisë në fjalë. Nga raporti i monitorimit të Zyrës dhe duke u bazuar në rrjedhën e punimeve të Kuvendit dhe implementimit të procedurave, Zyra konstaton se, kuvendi zgjedhor i partisë politike Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, është mbajtur në përputhje me Statutin e Partisë dhe Rregullat e KQZ-së.

Zyra, tha z. Hyseni, ka monitoruar edhe monitaur Kuvendin e Rregullt Zgjedhor të Partisë Liberale Egjiptiane - PLE, i cili kuvend mbajtur me datë 3 qershor 2022, në Prishtinë. Zyrtarja e Lartë Ligjore, Vesa Xharra, e ka monitoruar këtë kuvendi të mbajtur, dhe sipas raportit, Zyra konstaton se Kuvendi zgjedhor i partisë politike është bërë në përputhje me Statutin e Partisë dhe Rregullat e KQZ-së.

Me datë 12 qershor 2022, në përputhje me Rregullën 01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, më saktësisht neni 15 pika 1, i ka njoftuar dy parti politike: Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK) dhe Ujedinjena Stranka Bošnjaka (USB), që kanë obligim mbajtjen e kuvendeve të rregullta të radhës në muajin korrik 2022.

Ndër aktivitetet e tjera me rëndësi, z. Hyseni tha se më 6 dhe 7 qershor 2022, Zyra e RPPC ka marrë pjesë në punëtorinë e organizuar nga Këshilli i Evropës në mbështetje të Gjykatës Kushtetuese në zbatimin dhe përhapjen e standardeve evropiane për të drejtat e njeriut me temën: “Kontestet zgjedhore dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut”. Në këtë punëtori, veç përfaqësuesve të gjykatave vendore, kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e Komisionit të Venecias, ODIHR, Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe misionit të OSBE në Kosovë.

**Sami Kurteshi**, tha se në raste të tjera, unë do isha i interesuar të marrë pjesë në takime të këtilla, si kjo punëtori e organizuar nga Këshilli i Evropës, dhe është mirë të na informoni tjetër herë...

Në këtë pikë, diskutoi edhe Kreshnik Radoniqi. Ndërsa që, Ilir Gashi, pyeti rreth takimeve me qeverinë, e që ishte një çështje rreth pagave dhe një çështje të ligjit për zgjedhjet lokale...

Nexhmedin Hyseni, s'i përfaqësues tha se, rreth ligjit për paga kemi qenë njëherë, kurse ende s'ka diçka të re.. Na është thënë se një grup punues, është duke e hartuar një drafte... Kurse, Burim Ahmetaj tha se lidhur me koncept – dokumentin për zgjedhjet lokale, MAPL në fund të muajit do të mbaj një takim...

#### Rekomandim për pezullimin e partisë politike “Pokret za Župu i Dijasporu” me akronim ŽUPSKA:

Në vazhdim, z. Nexhmedin Hyseni, drejtor i ZRPPC tha se kemi një rekomandim për pezullimin e partisë politike “Pokret za Župu i Dijasporu” me akronim ŽUPSKA, e cila është e regjistruar me vendimin e KQZ-së me nr. 91/2021, dhe se, ky subjekt nuk e ka mbajtur kuvendin themelues, gjashtë muaj mbas regjistrimit. Dy herë, ka kërkuar shtyrjen. Afati i fundit i dhënë, ishte 31 maji 2022, mirëpo ky subjekt nuk e ka mbajtur kuvendin. Prandaj, zyra rekomandon pezullimin e këtij subjekti.

Anëtarët e KQZ -së, me 9 për miratuan pezullimin e partisë politike për shkak të mos mbajtjes së kuvendit zgjedhor.

#### Rekomandim për shtyrje të afatit të fundit për mbajtjen e Kuvendit Zgjedhor për Partinë e Ashkalinjëve për Integrim me akronimin PAI.

**Nexhmedin Hyseni**, drejtor i ZRPPC, tha se zyra më 27 maj, 2022, ka pranuar një kërkesë për shtyrje të afatit të fundit për mbajtjen e Kuvendit Zgjedhor për Partinë e Ashkalinjëve për Integrim me akronimin PAI. Ka dhënë arsye, sidomos për shkaqe financiare, prandaj ata kanë kërkuar që kuvendin ta mbajnë në korrik...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim dhe, caktuan që data e fundit e mbajtjes së kuvendit nga ky subjekt të jetë 31 korriku, 2022.

#### 4.Raport i Këshillave të KQZ-së

##### **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**

##### 1.Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë së Listës Votuese:

**Arianit Elshani:** Së pari, falënderoj OSBE-në për përkrahje ! KOZ-i, e ka shqyrtuar strategjinë e Listës Votuese, dhe e njëjta, ka qenë në shqyrim të gjerë të përbashkët në punëtorinë që e kemi mbajtur në

fillim të këtij viti. Dhe, në dy mbledhje e kemi shqyrtuar, gjithnjë me idenë e futjes së përvojave të të huajve. Duke i ditur sfidat e mëdha në këto 20 vite, kjo strategji adreson të gjitha ato që, lidhen me listën dhe procesin votues... si këshill i plotëson kërkesat, përgjegjshmërinë dhe përfshirjen e të gjitha palëve...Ne, e rekomandojmë për miratim...

Sami Kurteshi: E kam lëxuar me shumë kujdes, më ka pëlqyer sinqerisht por mendoj që kam nevojë edhe njëherë ta rishoh – rilexoj...! Ka përmbajtje të mirë, por mendoj që janë disa gjëra për të cilat, mund të diskutojmë...NË parim, jam për ta votuar, por ditëve të ardhshme do ta lexoj përsëri...

Me 9 vota për, miratohet Strategjia e Listës Votuese

## 2. Njoftim për Planin e Vizitave me Kryetar të Komunave të Republikës së Kosovës:

Arianit Elshani: Ne, kemi marrë një draft-plan nga Sekretariati për vizitat në komuna në fund të qershorit dhe përgjatë muajit korrik, pra takimi me kryetarët e tyre. Do të ndahemi në 3 grupe, dhe do të adresojmë çështje logjistike dhe nevojat e KQZ-së, si listat votuese, krijimi i QV-ve etj. Por, konsiderojmë që këto vizita të shtyhen në shtator, sepse tani jemi në periudhën e pushimeve, dhe takimet janë problematike...Pastaj, në këtë plan duhet të përfshijmë edhe informacionet sepse Sekretariati duhet ta bëjë një vlerësim të QV-ve, e veç shërbimet e terrenit janë të përfshirë edhe zyra e listës votuese, dhe kur kjo të kompletohet, ne do të kemi një pasqyrë më të qartë përgjatë takimit me kryetarët e komunave...

Sami Kurteshi, tha se pajtohet me shtyrjen, sepse edhe për të gjithë zyrtarët tanë komunal, Sekretariati duhet ta ketë një plan sepse ata janë pjesë e KQZ-së, dhe ata t'i kryejnë punët, detyrat e tyre..

## 5.Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Kamenicë dhe Mitrovicën e Veriut:

Sami Kurteshi: Këshilli, i ka shqyrtuar dy zëvendësime. Samiu mungon dhe ai, më ka autorizuar mua për ti udhëhequr dy mbledhjet e këshillit. Zyra ligjore, na ka siguruar se çdo gjë është në rregull dhe në përputhje me ligjin. Janë dy zëvendësime, në nga komuna e Kamenicës dhe një nga komuna e Mitrovicës së Veriut...

Ne rekomandojmë si këshill këto dy zëvendësime...

**Kreshnik Radoniqi:** Atëherë, në komunën e Kamenicës, i dorëhequri Valon Maqliqi zëvendësohet nga Labiont Maliqi nga subjekti **AKR**.

Miratohet ky zëvendësim me 9 vota!

**Kreshnik Radoniqi:** Në komunën e Mitrovicës së Veriut, Radovan Taniq ( ka vdekur) zëvendësohet nga Ninosllav Gjeriq nga subjekti Lista Serbe.

Miratohet ky zëvendësim me 9 vota!

## **6. Këshilli për Buxhet dhe Financa:**

Shqyrtimi dhe miratimi i draft-Plani i Buxhetit Komisionit Qendror te Zgjedhjeve 2023-2025:

**Gordana Llaban:** Këshilli, në takimin e 9-të të mbajtur me 20 qershor ka shqyrtuar Draft - planin e buxhetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për periudhën: 2023-2025. Këshilli për Buxhet dhe Financa, së pari kemi shqyrtuar udhëzimin që e kemi marrë nga qeveria, dhe pastaj, e ka hartuar këtë plan. Në bazë të analizës detale që kemi bërë, i kemi analizuar edhe kategoritë kryesore buxhetore. Në raport, është gjithçka e analizuar dhe e trajtuar. Ky plan, përfshinë tri programe...

Znj, Llaban, paraqiti pasqyrën e ndarjes – planifikimit të mjeteve sipas kategorive, dhe programit.

Në përgjithësi, draft – plani, përmban 6, 817, 989 euro sipas analizës dhe hartimit të planit nga KQZ. Kurse qeveria, do t'i ndajë 6, 187, 041 euro. Dallimi pra nga planifikimi ynë dhe buxhetimi qeveritarë, është: 630, 948 euro.

Ne, tani na duhet kemi një vendim rreth këtij plani, pra ta votojmë...!

**Sami Kurteshi,** pyeti rreth shpenzimeve lidhur me lëvizjet brenda vendit dhe jashtë vendit, pavarësisht se janë dy palë zgjedhje. Shpenzimet rriten dikur deri në 50 %, po ashtu, janë edhe shpenzimet e telefonisë mobile janë të tepërta...! Në kërkesat për investime kapitale, kemi pak ! Te automjetet, kur po i shoh shpenzimet po trishtohna...! Qiraja për makineri: 50 mijë-50 mijë - 50 mijë.... Çka është kjo...? Po dal te drekat zyrtare: 22 960 euro për vitin 2023, 68 000 për vitin 2024, kurse 44 500 për vitin 2025...

**Arianit Elshani,** tha se ky plan është i bazuar në kërkesat e njësive. Të kemi një krahasim me vitet paraprake, ka përsëritje me vitet pasuese. Mendoj që disa shpenzime sot janë më pak, krahasuar me



të kaluarën, furnizimi me letër ta zëmë A 3 dhe A 4... Pata pyetje rreth AËEB dhe ACEEEO pse janë të përfshira që të dyja, pastaj identifikimi elektronik i votuesve me shumën prej 50 mijë euro, pak më shumë shpjegime për këtë projekt...Te viti 2024 parashikohet një projekt trajnimi për KKZ-të, kurse në 2025 jo, ndërsa që ligjërisht ky vit është vit zgjedhor... Ka edhe të tjera aktivitete që, duhet shqyrtuar, shpjeguar...

**Ilir Gashi:** E kemi trajtuar edhe në këshill këtë raport dhe është miratuar me disa sugjerime, veçse ky projektion ju referohet viteve krahasuese të kaluara. Drekave zyrtare, që u përmenden s'i kemi bërë analizë, por në bazë të analizave ka mundësi që të ndërhyhet, për këtë e diskutojmë dhe mund të bëhen përmirësime etj. Por, projekti nuk mendoj që ka anomali dhe për këtë unë e kam dhënë edhe pëlqimin...

**Sami Kurteshi:** Ne kemi shpenzime marketingu, por botime e publikime kemi "zero" ! Kjo, është punë e jona që duhet ta bëjmë, duhet por ne kemi zero publikime. Konkursat dihen, por reklamat çka janë...? Shpenzimet për informim publik dalin 440 mijë euro në vit zgjedhor, kurse paraprakisht, ne kemi s'kemi informim publik pra zgjedhjeve: zero në vitin 2023, kemi 1000 në vitin 2024, kurse 440 mijë euro në vitin 20125...?!

Thënë në gjuhën popullore, "një ditë para bajramit, e blejmë dhe e mbajmë çuranin...!" Nuk po bëjmë asfara informimi publik. Bash aty ku kemi nevojë për informim publik, nuk kemi asgjë, asnjë mjet të ndarë...Drekat zyrtare, qiraja për hapësira, për pajisje, për...

Në këtë pikë, diskutuan: Ibrahim Selmanaj, Arianti Elshani, Alim Rama, Miradije Meha, drejtoresh e DAP, e cila, në detaje i shpjegoi mënyrat dhe arsyet e hartimit të raportit, duke dhënë edhe përgjegje në disa prej pyetjeve të shtruar nga anëtarët e KQZ-së. Po ashtu, diskutuan sërish kryetari Radoniqi, Alim Rama dhe Sami Kurteshi.

**Kreshnik Radoniqi:** Unë, tash po e hedh në votim në parim, por deri më 24, ne duhet ta dorëzojmë. Nëse keni ende diçka tjetër, mundohuni me i inkorporue.

**Alim Rama:** Nuk janë parapa vlerat për informim publik për shembull për vitin 2024, unë kam kërkuar që të sinkronizohen dokumentet...

Në fund, kryeshefi **Burim Ahmetaj**, shpjegoi disa nga pyetjet e parashtruara, dhe analizoi "disproporcionet" dhe "nevojat" në raport me diskrepancën e mjeteve të hartuara në raportin buxhetor...

**Kreshnik Radoniqi:** Unë, nuk po fshehi asgjë, nuk pi kuptoj shifrat, t'ua lëmë ekspertëve se për besë problem, prandaj unë jam që ta miratojna...E hedh në votim...? Kush është për...?

Me 8 vota për, 1 abstenim ( Sami Kurteshi), miratohet draft-plani i buxhetit: 2023-2025

**Shqyrtimi dhe miratimi i Raporti Vjetor Financiar i Fondit për Mbështetje të Subjekteve Politike për vitin 2021:**

**Gordana Llaban:** Me ligjin e Kosovës të vitit 2021 për fondin e mbështetjes së subjekteve politike, fondi ka qenë 4, 200, 000 euro. Në periudhën janar – dhjetor, me vendim të KQZ-së subjekteve që kanë fituar vende në Parlament, u janë ndarë buxheti prej 3, 901 694 euro. Buxheti në vlerë prej 271 477, 87 euro, është alokuar për grupet parlamentare, është realizuar në tërësi, përfshirë edhe pagat e deputetëve. Në këshill, kemi sjellë vendimin që të bëhet pagesa e mjeteve.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për miratim të raportit ?

Me 9 vota për, miratohet.

## **7 Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për anëtar të jashtëm të Komitetit të Auditimit të Brendshëm të KQZ-së**

**Kreshnik Radoniqi:** Ka ardhë propozimi nga Universiteti për zëvendësimin e anëtarit të dorëhequr...

**Alim Rama:** A janë respektuar procedurat, a kemi një raport...?

**Burim Ahmetaj,** kemi dërgue dhe ridërguar ftesë Komisionit të Pavaruar për Media, dhe Univesitetit. Prej shoqërisë civile, nuk ka shpreh askush interesim. Universiteti, ka shpreh interesim. Është propozuar, Përparim Shurdhiqi...

Kjo është procedura që kemi dnjekur...

**Kreshnik Radoniqi:** Nëse nuk kemi tjetër, e hedh në votim. Kush është për...?

Me 8 vota për, z. Përparim Shurdhiqi, aprovohet s'i anëtar i jashtëm i Komitetit të Auditimit të Brendshëm të KQZ-së.

## **7 Të ndryshme:**

**Xhemajl Pecani**, zëvendëskryeshef, e informoi KQZ-në rreth një ftese lidhur me organizimin e një punëtorie. Ky është takimi i dytë, për takimin e parë jeni njoftuar... Është bërë një draft – agjendë, pjesëmarrës janë të gjithë ata që kanë marrë pjesë edhe në puëtorinë e parë ! Ne, kemi filluar t'i identifikojmë sfidat nga zgjedhjet e kalaura në Sekretariat, sfidat që lidhen me rregullat zgjedhore, dhe me ligjin për zgjedhjet...

Ne, mund ti japim sugjerimet tona rreth koncept - dokumentit...

**Sami Kurteshi**: Kurgja nuk kuptova, kush e ka bërë ftesën...?

**Xhemajl Pecani**: Ministria e Pushtetit Lokal...

**Illir Gashi**: Nga ajo sa e kuptova, ka një punëtori dhe këta shkojnë, mbas saj, ne e marrim materialin dhe ne mund ta shqyrtojmë dhe t'i japim mendimet tona...

**Kreshnik Radoniqi**: Unë, nuk do të jem këtu javën tjetër, kështu që nëse ka nevojë për ndonjë takim, sipas radhës kryesohet takimi ngaanëtari i KQZ-së...

**Për KQZ**

**Kreshnik Radoniqi, kryetar**

-----